LIGJ
Nr. 10 130, datë 11.5.2009

PËR FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

(Ndryshuar me Aktin Normativ nr. 7[1], datë 30.9.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni l
Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e formës së organizimit, të rregullave të funksionimit dhe të administrimit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (në vijim FSHZH).

Neni 2
Qëllimi

Fusha e veprimtarisë së FSHZH-së është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "FSHZH" është Fondi Shqiptar i Zhvillimit;

b) "Statuti" është akti që parashikon rregullat e funksionimit të brendshëm të FSHZH-së, dalë në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji;

c) "Manuali i procedurave" është manuali i procedurave drejtuese, administrative, financiare dhe teknike të FSHZH-së;

ç) "Projekt" janë projektet ose programet e zhvillimit, që zbatohen nga FSHZH-ja, të financuara nga donatorë të ndryshëm dhe/ose nga shteti;

d) "Donator" janë të gjitha institucionet financiare dhe bankare, kombëtare dhe ndërkombëtare, publike apo private, të vendit dhe të huaja, që financojnë projekte zhvillimi, për t'u zbatuar nga FSHZH-ja.

---

[1] *Akti Normativ nr. 7, datë 30.9.2009 është miratuar me ligjin nr. 10177, datë 29.10.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, datë 27.11.2009.*

Neni 4
Statusi juridik

1. FSHZH-ja është person juridik dhe gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse.

2. FSHZH-ja gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike.

3. FSHZH-ja e ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me statutin, manualin e procedurave, si dhe me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet e financimit dhe të zbatimit të projekteve.

4. FSHZH-ja është e organizuar si një subjekt juridik, me qendër në Tiranë, që ka të drejtë të krijojë struktura të tjera, në nivel vendor, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në statut.

Neni 5
Objektivat e FSHZH-së

Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj, FSHZH-ja udhëhiqet nga këta objektiva kryesorë:

a) përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike vendore;

b) përmirësimi i shërbimeve publike vendore;

c) forcimi institucional i njësive të qeverisjes vendore;

ç) nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Neni 6
Kompetencat e FSHZH-së

1. Objekti i veprimtarisë së FSHZH-së është, sipas rastit, hartimi, menaxhimi, financimi, zbatimi, mbikëqyrja e projekteve të lidhura me fushën e veprimtarisë.

2. Kompetencat kryesore të FSHZH-së janë:

a) menaxhimi i projekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm, që kanë si qëllim zhvillimin rajonal dhe vendor.

b) dhënia e mbështetjes financiare në të gjitha format, si grant, hua, garanci etj. për njësitë e pushtetit vendor, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore;

c) dhënia e mbështetjes teknike për zbatimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e investimeve, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore;

ç) dhënia e asistencës teknike dhe kryerja e trajnimeve, për rritjen e kapaciteteve institucionale të pushtetit vendor;

d) kryerja e veprimtarive të ndryshme, në funksion të zbatimit të politikave e të instrumenteve të zhvillimit rajonal dhe vendor.

3. FSHZH-ja bashkëpunon, bashkërendon dhe i harmonizon veprimtaritë me institucionet publike dhe organizmat e tjerë shtetërorë, organizatat e shoqërisë civile dhe me organizma të tjerë shoqërorë, që veprojnë në fusha apo sektorë të lidhur me zhvillimin rajonal dhe vendor.

4. Në menaxhimin e projekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorët, në përputhje me objektin e veprimtarisë së këtij fondi, Këshilli i Ministrave mund ta kontraktojë me FSHZH-në, sipas marrëveshjeve përkatëse.

Neni 7
Parimet e kryerjes së veprimtarisë së FSHZH-së

FSHZH-ja, në kryerjen e veprimtarisë dhe në ofrimin e mbështetjes për njësitë e qeverisjes vendore, mbështetet, sipas rastit, në parimet e mëposhtme:

a) përparësia sektoriale dhe/ose territoriale, në përputhje me përparësitë e politikës shtetërore në zhvillimin rajonal e vendor;

b) trajtimi në mënyrë të drejtë e të barabartë i njësive të qeverisjes vendore, në kushte të ngjashme ndërmjet tyre;

c) zbatimi i procedurave transparente, të thjeshta dhe të kontrollueshme;

ç) nxitja e pjesëmarrjes së komuniteteve vendore në identifikimin e nevojave e të përparësive vendore, zbatimin e projekteve dhe monitorimin e tyre;

d) bashkëkontributi i njësive të qeverisjes vendore në financimin e projekteve;

dh) bashkëpunimi ndërmjet njësive të qeverisjes vendore;

e) konkurrenca ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, sipas nevojave, dobishmërisë publike të projekteve dhe plotësimit më të mirë të parimeve të tjera, të përcaktuara në këtë nen;

ë) parime e kritere të tjera, të përcaktuara në marrëveshjet me donatorët apo në kushtet e përcaktuara për fondet e dhëna nga Buxheti i Shtetit.

KREU II
KAPITALI DHE BURIMET E FINANCIMIT

Neni 8
Burimet e financimit

1. Të ardhurat në buxhetin e FSHZ-së krijohen nga:

a) fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të ndryshëm, për financimin e projekteve, të zbatuara nga FSHZH- ja;

b) fondet nga Buxheti i Shtetit, nga individë dhe institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse;

c) fondet nga bashkëfinancimi i përfituesve dhe i njësive të qeverisjes vendore;

ç) të ardhurat e përfituara nga aktivet e saj dhe shërbimet e ofruara;

d) kontributet materiale nga programet dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe nga organizata të ndryshme jofitimprurese;

dh) burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Të ardhurat e krijuara FSHZH-ja i përdor për financimin veprimtarive të veta, sipas procedurave të përcaktuara në statut.

KREU III
STRUKTURA, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I FSHZH-SË

Neni 9
Organet drejtuese

Organet drejtuese të FSHZH-së janë:

a) këshilli drejtues;

b) drejtori ekzekutiv.

Neni 10

Përbërja e këshillit drejtues

(Ndryshuar nënndarja "i" e shkronjës "a" të pikës 1 me aktin normativ nr. 7, datë 30.9.2009)

1. Këshilli drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i FSHZH-së dhe përbëhet nga 11 anëtarë.

a) pesë anëtarë janë përfaqësues të pushtetit qendror, nga të cilët:

i) Kryetari i këshillit drejtues të FSHZH-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

ii) katër anëtarë të këshillit drejtues janë funksionarë, në nivel ministri apo zëvendësministri, sipas fushave përkatëse, në kuadër të projekteve, që ka në zbatim FSHZH -ja, të cilët emërohen dhe shkarkohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) gjashtë anëtarët e tjerë janë përfaqësues të pushtetit vendor, nga të cilët:

i) 2 kryetarë qarqesh, të caktuar nga Shoqata e Kryetarëve të Këshillave të Qarqeve;

ii) 2 kryetarë bashkie, të caktuar nga Shoqata e Kryetarëve të Bashkive;

iii) 2 kryetarë komunash, të caktuar nga Shoqata e Kryetarëve të Komunave.

2. Afati i qëndrimit në detyrën të anëtarit të këshillit drejtues është i njëjtë me mandatin e tyre si të zgjedhur të pushtetit vendor.

3. Nëse mandati i përfaqësuesve të pushtetit vendor revokohet para mbarimit të tij, shoqatat përkatëse propozojnë emrin e anëtarit të ri në këshillin drejtues të FSHZH-së.

Neni 11

Detyrat e këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues ka këto detyra:

a) miraton drejtimet kryesore të veprimtarisë së FSHZH-së;

b) miraton statutin dhe manualin e procedurave të FSHZH-së me 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve;

c) miraton marrëveshjet e zbatimit dhe/ose të financimit të projekteve;

ç) emëron dhe shkarkon drejtorin ekzekutiv, në mbështetje të nenit 12 të këtij ligji;

d) mbikëqyr administrimin dhe veprimtarinë e FSHZH-së;

dh) miraton strukturën organizative të FSHZH-së;

e) miraton kushtet dhe kriteret bazë të marrëdhënieve të punësimit në FSHZH, përfshirë strukturën dhe nivelet e pagave të punonjësve;

ë) miraton bilancin vjetor, raportet vjetore dhe raportet periodike të veprimtarisë së FSHZH-së.

f) miraton buxhetin vjetor të FSHZH-së;

g) analizon dhe miraton raportet e kontrolleve të kryera për veprimtarinë e FSHZH-së.

gj) miraton rregulloren për funksionimin e këshillit drejtues;

h) merr vendime për çështje, që lidhen me veprimtarinë e FSHZH-së dhe miraton dokumentet e nevojshme për ecurinë e kësaj veprimtarie.

2. Këshilli drejtues ka dhe një sekretar, i cili zgjidhet ndërmjet punonjësve të

administratës së FSHZH-së.

3. Mënyra dhe procedurat më të hollësishme të ushtrimit të kompetencave të këshillit drejtues përcaktohen në statutin, manualin e procedurave dhe në rregulloren e funksionimit të tij.

Neni 12

Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv është autoriteti më i lartë ekzekutiv i FSHZH-së.

2. Drejtori ekzekutiv përgjigjet përpara këshillit drejtues.

3. Drejtori ekzekutiv emërohet me një shumicë prej 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit drejtues të FSHZH-së.

4. Drejtor ekzekutiv zgjidhet personi që:

a) është shtetas shqiptar;

b) nuk ka qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale;

c) ka mbaruar arsimin e lartë në ekonomik ose juridik;

ç) zotëron kualifikime pasuniversitare të profilit;

d) ka një përvojë pune mbi 3 vjet në menaxhimin e projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm;

dh) zotëron një ose më shumë gjuhë të huaja.

5. Afati i qëndrimit në detyrë të drejtorit ekzekutiv është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

6. Drejtori ekzekutiv shkarkohet nga detyra para afatit me një shumicë prej 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit drejtues të FSHZH-së, vetëm në rast se:

a) dënohet nga gjykata, me vendim të formës së prerë, për një vepër penale;

b) është në pamundësi fizike ose mendore për të ushtruar funksionet e ngarkuara, për një periudhë mbi gjashtë muaj;

c) shkel rëndë rregullat e etikës së punës, të cilat përcaktohen nga këshilli drejtues në manualin e procedurave të FSHZH-së;

ç) nuk përmbush detyrat e caktuara sipas nenit 13 të këtij ligji;

d) jep dorëheqjen.

Neni 13

Kompetencat e drejtorit ekzekutiv

1. Të gjitha kompetencat, që nuk specifikohen për këshillin drejtues, i njihen drejtorit ekzekutiv të FSHZH-së. Në veçanti, drejtori ekzekutiv ka kompetencat e mëposhtëme:

a) është përfaqësuesi ligjor i FSHZH-së;

b) drejton veprimtarinë administrative dhe organizative të FSHZH-së dhe ndjek zbatimin e vendimeve të këshillit drejtues;

c) administron burimet financiare të FSHZH-së;

ç) nënshkruan marrëveshjet me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe donatorë të ndryshëm;

d) zgjedh dhe emëron personelin;

dh) kërkon thirrjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme të këshillit drejtues;

e) kryen të gjitha detyrat e tjera, që i ngarkon ky ligj, statuti dhe manuali i procedurave të FSHZH-së.

2. Mënyra dhe procedurat e ushtrimit të kompetencave të drejtorit ekzekutiv përcaktohen në statut dhe në manualin e procedurave të FSHZH-së.

Neni 14
Administrata e FSHZH-së

1. Veprimtaria e FSHZH-së mbështetet nga një administratë, që funksionon në përputhje me statutin dhe manualin e procedurave të FSHZH-së.
2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të kësaj administrate rregullohen sipas Kodit të Punës.

Neni 15
Konflikti i interesit

Gjatë veprimtarisë së tyre, punonjësit e FSHZH-së parandalojnë dhe shmangin konfliktin e interesave, sipas legjislacionit në fuqi, statutit dhe manualit të procedurave të FSHZH-së.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 16
Vazhdimësia e të drejtave dhe detyrimeve

1. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e FSHZH-së, në raport me palë të treta, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të mbeten në fuqi, sipas përcaktimeve në aktet apo marrëveshjet përkatëse me këto palë.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha asetet financiare dhe fizike, në pronësinë aktuale të FSHZH-së, vazhdojnë të mbeten në pronësi të tij.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, asetet, që janë në administrim të FSHZH-së, vazhdojnë të mbeten në administrim të tij, deri në një vendim tjetër të organeve përkatëse.
4. Për efekt të regjistrimit tatimor, FSHZH-ja vazhdon të mbajë numrin e NIPT-it, që ka në përdorim.

Neni 17
Krijimi i organeve të para drejtuese

1. Anëtarët e këshillit drejtues, përfaqësues të pushtetit qendror, caktohen jo më vonë se 30 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe propozohen në mbështetje të nenit 10 të tij.
2. Drejtori ekzekutiv zgjidhet jo më vonë se 45 ditë nga data e hyrjes në fuqi të ligjit dhe emërohet në mbështetje të nenit 12 të këtij ligji.
3. Anëtarët aktualë të këshillit drejtues, përfaqësues të pushtetit vendor, qëndrojnë në këtë detyrë deri në përfundim të mandatit të tyre, si të zgjedhur të pushtetit vendor.
4. Statuti dhe manuali i procedurave miratohen nga këshilli drejtues jo më vonë se 60 ditë nga data e krijimit të këtij këshilli.
5. Organet drejtuese të FSHZH-së para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të kryejnë

detyrat e tyre deri në krijimin e organeve drejtuese, sipas afateve të sipërpërmendura.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pika 2 e vendimit nr. 12, datë 9.1.1993 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin, në parim, të projektit të Bankës Botërore "Për lehtësimin e varfërisë së zonave rurale", i cili krijon "Fondacionin për Zhvillim Rural", të ndryshuar dhe aktet nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 6181, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi